

PËRMBLEDHJE E RAPORTIT VJETOR PËR VEPRIMTARINË E BANKËS SË SHQIPËRISË GJATË VITIT 2025

1. KUADRI LIGJOR KU MBËSHTETET VEPRIMTARIA E BANKËS SË SHQIPËRISË

Banka e Shqipërisë (BSH) është banka qendrore e Republikës së Shqipërisë, e themeluar sipas nenit 161 të Kushtetutës dhe Ligjit nr. 8269/1997 “Për Bankën e Shqipërisë” i ndryshuar, që përcakton objektivat, detyrat, organizimin dhe marrëdhëniet me shtetin dhe sistemin financiar. BSH ka si objektiv kryesor arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve dhe vepron e pavarur nga çdo pushtet tjetër, duke iu përgjigjur Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Veprimtaria e Bankës së Shqipërisë mbështetet në një kuadër ligjor të gjerë që përfshin Kushtetutën dhe ligjin përkatës, ligjin për bankat nr. 9662/2006, i ndryshuar, ligjet për sistemin dhe shërbimet e pagesave (nr. 133/2013 dhe nr. 55/2020), ligjin për shoqëritë e kursim-kreditit nr. 52/2016, si dhe ligjet për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka nr. 133/2016. Në veprimtarinë e saj, BSH i referohet gjithashtu statutit të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës, duke siguruar kështu funksionimin e rregulluar dhe të standardizuar të rolit të saj si bankë qendrore.

2. ZBATIMI I REZOLUTËS SË KUVENDIT PËR VEPRIMTARINË E BANKËS SË SHQIPËRISË

Banka e Shqipërisë ka përmbushur rekomandimet e lëna nga Kuvendi, dhe ka raportuar rregullisht gjatë vitit për ecurinë e zbatimit të tyre.

3. AMBIENTI EKONOMIK E FINANCIAR NË TË CILIN KA VEPRUAR BANKA E SHQIPËRISË

Ambienti ekonomik e financiar mbeti kompleks dhe sfidues gjatë vitit 2025. Pasiguria globale, ndryshimet në politikat dhe zinxhirët tregtarë, si dhe luhatjet e çmimeve bazë ndikuan inflacionin, ndërsa flukset e larta valutore si pasojë e rritje së eksporteve totale ushtruan presione për forcimin e Lekut. Ndërkohë, rritja e kreditimit dhe digjitalizimi financiar kërkuar vëmendje për ruajtjen e standardeve të kreditimit dhe parandalimin e akumulimit të rreziqeve në bilancet e bankave.

Në këtë kontekst, Banka e Shqipërisë ndoqi një qasje të kujdesshme monetare dhe makroprudenciale: politika monetare pati kah lehtësues çka ndihmoi ankorimin e pritjeve për inflacionin dhe krijoi kushte të favorshme financimi për rritjen e ekonomisë, ndërsa prania e rritur në tregun valutor kontribuoi në ruajtjen e një stabiliteti relativ të kursit të këmbimit. Njëkohësisht, mbikëqyrja e kujdesshme dhe shtrëngimi i masave makroprudenciale rriti qëndrueshmërinë e sektorit bankar, ndërsa avancimet në infrastrukturën e pagesave dhe adoptimi i standardeve evropiane, përfshirë hyrjen në SEPA, përmirësuan efikasitetin, konkurrencën dhe mundësitë për inovacion.

Kjo qasje kontribuoi në mbarëvajtjen e ekonomisë, si në drejtim të rritjes ekonomike ashtu edhe të konsolidimit të stabilitetit makroekonomik.

Zhvillimet ekonomike dhe stabiliteti monetar

Ekonomia shqiptare shënoi një ecuri solide gjatë vitit 2025. Aktiviteti ekonomik u rrit me 3.7% gjatë tre tremujorëve parë të vitit dhe treguesit e disponuar sugjerojnë një ritëm të ngjashëm edhe në tremujorin e fundit, duke e mbajtur rritjen pranë potencialit afatmesëm të ekonomisë. Kjo ecuri u reflektua dhe në tregun e punës: punësimi në sektorin privat jo-bujqësor u rrit mesatarisht me 4.7% gjatë tre tremujorëve të parë, ndërsa norma e papunësisë qëndroi pranë nivelit 8.1%. Po ashtu, pagat në sektorin privat u rritën me një ritëm mesatar prej 9.4% në terma nominale dhe 7.2% në terma reale, duke treguar se rritja ekonomike po përkthehet në përmirësim të mirëqenies për një pjesë të madhe të shoqërisë.

Në të njëjtën kohë, parametrat kryesorë të stabilitetit ekonomik e financiar të vendit janë përmirësuar më tej.

Së pari, inflacioni i çmimeve të konsumit ishte i ulët dhe i qëndrueshëm, duke u luhatur rreth një niveli mesatar prej 2.2%. Kjo ecuri u ndikua nga një balancim më i mirë i kërkesës dhe ofertës për mallra e shërbime, nga presionet e ulëta inflacioniste nga jashtë, si dhe nga pritjet e ankoruara për inflacionin.

Së dyti, pozicioni fiskal dhe ai i huaj i vendit u forcuan, duke rritur rezistencën e ekonomisë ndaj goditjeve potenciale të brendshme e të huaja. Raportet e borxhit publik dhe të huaj ndaj PBB-së shënuan rënie, ndërsa rezervat valutore arritën në 7.3 miliardë Euro në fund të vitit. Po ashtu, gjatë tre tremujorëve të parë të vitit, llogaria korrente kaloi – për herë të parë në historinë post-tranzicion – në suficit, e nxitur nga një sezon i mirë turistik dhe nga rritja e të ardhurave nga remitancat dhe puna sezonale. Këto prurje, së bashku me rritjen e investimeve të huaja direkte, e mbajtën kursin e këmbimit të Lekut në një trend mbiçmues.

Së treti, tregjet financiare funksionuan normalisht, të mbështetura nga likuiditeti i bollshëm dhe qëndrimi i kujdesshëm i politikës monetare. Ato u karakterizuan nga volatilitet i ulët i normave të interesit dhe qëndrueshmëri më e lartë e kursit të këmbimit, prime të kontrolluara rreziku dhe kosto të favorshme kreditimi. Sektori bankar ruajti tregues të mirë likuiditeti, kapitalizimi dhe përfitueshmërie, çka mundësoi një ofertë të mjaftueshme kredie për të mbuluar kërkesën dhe zgjerimin e gamës së shërbimeve financiare. Në këtë mjedis, kredia për sektorin privat u rrit me 14.4% gjatë vitit, e mbështetur nga zgjerimi i kredisë në Lekë dhe asaj për investime. Rritja e kredisë në Lekë përmirëson efektivitetin e politikës monetare dhe zbut rreziqet ndaj stabilitetit financiar, ndërsa kreditimi i investimeve mbështet zgjerimin e kapaciteteve prodhuese të ekonomisë.

Këta tregues krijojnë premisa për vazhdimin e trendeve pozitive të viteve të fundit.

Perspektiva ekonomike paraqitet pozitive. Ekonomia shqiptare pritet të ruajë një ritëm solid rritjeje gjatë viteve të ardhshëm, të përafërt me potencialin e saj, ndërsa inflacioni parashikohet të kthehet gradualisht drejt objektivit gjatë vitit 2026.

Megjithatë, rreziqet mbeten të pranishme. Në ambientin e huaj, konfliktet gjeopolitike, fragmentimi i tregjeve dhe luhatjet e çmimeve ndërkombëtare, pritet të vijnë të jenë burime pasigurie, me potencial për të gjeneruar goditje të reja mbi inflacion. Në ambientin e brendshëm, trendet e pafavorshme demografike mund të kufizojnë potencialin e rritjes, përmes tkurrjes së forcës së punës dhe presioneve mbi produktivitet, si dhe të dëmtojnë qëndrueshmërinë e skemës së pensioneve dhe të reduktojnë hapësirat fiskale. Paralelisht, baza e ngushtë sektoriale krijon ekspozim më të lartë se ndaj goditjeve sektoriale. Adresimi i këtyre sfidave kërkon politika të kujdesshme dhe reforma të mëtejshme strukturore.

Ecuria e sektorit bankar dhe stabiliteti financiar

Viti 2025 shënoi zhvillime pozitive në sektorin bankar, me përmirësim të cilësisë së portofolit të kredisë dhe forcim të qëndrueshmërisë financiare. Kredia me probleme zbriti në 3.8% në fund të vitit, niveli më i ulët historik që prej vitit 2008. Kapitalizimi i sistemit mbeti i lartë, me treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit të rritur në 20.36% dhe treguesit e likuiditetit ndjeshëm mbi kërkesat rregullatore. Rezultati financiar arriti në 36 miliardë Lekë, ndërsa treguesit e përfitueshmërisë ndaj asetëve dhe kapitalit ishin përkatësisht 1.64% dhe 15.94%. Rritja e aktiveve të sistemit me 9% u mbështet nga zgjerimi i depozitave dhe kapitalit, duke mundësuar rritjen e investimeve në kredi dhe letra me vlerë. Numri i bankave tregtare mbeti 11.

Analizat tona tregojnë se rreziqet sistemike në sistemin financiar janë relativisht të përmbajtura dhe se sektori bankar ka kapacitete për të përballuar goditje potenciale makrofinanciare. Megjithëse prirjet e vitit tregojnë zbutje të disa rreziqeve, zgjerimi i kredisë për pasuri të paluajtshme rezidenciale, niveli ende i lartë i kredisë në valutë dhe hendekët e maturimit midis aktiveve dhe pasiveve vazhdojnë të mbeten në vëmendjen tonë. Bazuar në këto vlerësime, Banka e Shqipërisë vendosi të ruajë kërkesa të larta për kapital dhe të zbatojë për herë të parë kufij ndaj raporteve të standardeve të kreditimit për pasuri të paluajtshme rezidenciale.

Infrastruktura e pagesave

Banka e Shqipërisë vijoi punën për modernizimin e infrastrukturës së pagesave. Gjatë vitit 2025 përfundoi projekti për përditësimin e sistemeve kombëtare të pagesave me standardin ndërkombëtar ISO 20022, si dhe u rishikua kuadri rregullator i funksionimit të tyre, përfshirë tarifat për klientët me qëllim uljen e kostove. Pas anëtarësimit të Shqipërisë në Tregun Unik të Pagesave në Euro (SEPA), të gjitha bankat në Republikën e Shqipërisë nisën kryerjen e transfertave SEPA në 7 tetor 2025, duke mundësuar transaksione më të sigurta, më të shpejta dhe me kosto më të ulët.

Prirja rritëse e pagesave elektronike vijoi, duke reflektuar përparimin e digjitalizimit të shërbimeve financiare dhe lehtësimin e transaksioneve për individët dhe bizneset. Numri dhe vlera e pagesave elektronike vazhduan të rriten ndjeshëm, ndërsa treguesi i përdorimit për frymë arriti 29, duke zgjeruar përfshirjen financiare dhe përshpejtuar digjitalizimin e ekonomisë. Për herë të parë, në vitin 2025 kartat u përdorën kryesisht për kryerjen e pagesave, duke thyer modelin shumëvjeçar të përdorimit të tyre kryesisht për tërheqje të *cash-it*.

Politikat ekonomike mbështetëse dhe rezultatet e tyre

Banka e Shqipërisë ndoqi një politikë monetare të kujdesshme dhe me kah lehtësues. Ky qëndrim ndihmoi në kontrollin e inflacionit në nivele të ulëta, ruajti fuqinë blerëse të familjeve, uli pasiguritë në tregjet financiare, nxiti rritjen e kreditimit, si dhe mundësoi ruajtjen e trendeve pozitive të rritjes e zhvillimit. Lehtësimi i qëndrimit u materializua nëpërmjet uljes së normës bazë të interesit në nivelin 2.5% në muajin korrik dhe rritjes së blerjeve të valutës në tregun e brendshëm. Në të njëjtën kohë, reagimi në kohë ndaj luhatjeve të inflacionit siguroi ankorimin e pritjeve për inflacionin pranë objektivit 3%.

Politika makroprudenciale e Bankës së Shqipërisë synoi zbutjen e rreziqeve sistemike dhe forcimin e stabilitetit financiar. Në këtë kuadër, BSH ruajti masat ekzistuese makroprudenciale të kapitalit, përfshirë shtesën konservuese prej 2.5%, shtesën kundërciklike të kapitalit, e cila u rrit në 0.5%, si dhe shtesën për bankat me rëndësi sistemike. Paralelisht me to, në muajin maj 2025 u vendosën për herë të parë kufij maksimalë për raportet “kredi ndaj vlerës së kolateralit” dhe “shërbimi i borxhit ndaj të ardhurave” për kreditë për pasuri të paluajtshme rezidenciale. Këto masa synojnë forcimin e standardeve të kreditimit, uljen e rrezikut të mospagimit dhe rritjen e qëndrueshmërisë së sektorit bankar ndaj zhvillimeve të pafavorshme. Zbatimi i këtyre masave dhe përmbushja e kërkesave për funksionin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme në banka, ka kontribuar në forcimin e qëndrueshmërisë dhe shëndetit të sektorit bankar.

Harmonizimi i politikave makroekonomike ka mbështetur stabilitetin makroekonomik të vendit, duke krijuar premisa për rritje të qëndrueshme të ekonomisë. Konsolidimi fiskal ka forcuar qëndrueshmërinë e financave publike dhe ka zgjeruar hapësirat e reagimit ndaj goditjeve. Qasja e kujdesshme, konsistente dhe proaktive e politikës monetare ndaj zhvillimeve në inflacion ka mundësuar ruajtjen e stabilitetit monetar, ndërsa politikat financiare – përfshi mbikëqyrjen, masat makroprudenciale, dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme – kanë forcuar sektorin bankar dhe aftësinë e tij për të përballuar rreziqet dhe goditjet e mundshme.

4. DREJTIMET KRYESORE TË PUNËS SË BANKËS SË SHQIPËRISË GJATË VITIT 2025

Banka e Shqipërisë ka realizuar funksionet e saj duke respektuar detyrimet ligjore, duke arritur objektivat strategjikë afatmesëm dhe duke përmbushur kërkesat e Kuvendit. Më poshtë, përmbledhen disa nga drejtimet kryesore të veprimtarisë së saj, krahas atyre të raportuara në raportet periodike.

i. Në fushën e politikës monetare, vijoi puna për përmirësimin dhe pasurimin e modeleve makroekonometrike, integrimin e të dhënave të reja dhe analizat e thelluara të çështjeve specifike. Në të njëjtën kohë, u intensifikua komunikimi publik për të rritur efektivitetin e politikës monetare. Këto hapa mbështetën një vendimmarje të mirë-informuar, pro-aktive dhe në përputhje me kushtet ekonomike e financiare.

ii. Në fushën e stabilitetit financiar, vijoi puna për hartimin dhe zbatimin e shtesës së kapitalit për rrezikun sistematik, zbatimin e masave kufizuese për raportet e kredimarrjes në tregun e pasurive të paluajtshme, si dhe zhvillimin e vrojtimin për ndikimin e rreziqeve klimatike në sektorin bankar. Në të njëjtën kohë, janë përgatitur dhe rishikuar projektligje dhe akte rregullatore në përputhje me kuadrin ligjor të BE-së. Këto hapa kontribuan në forcimin e stabilitetit të sektorit bankar, si dhe harmonizimin me standardet evropiane.

iii. Në fushën e mbikëqyrjes, vijoi puna për rishikimin dhe hartimin e kuadrit ligjor dhe rregullator në drejtim të përafrimit të plotë të kërkesave të *acquis* të BE-së. Pjesë e rëndësishme e këtij procesi ishte puna për hartimin e ligjit të ri “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe për hartimin e ndryshimeve të ligjit “Për shërbimet e pagesave”. Në funksion të përmirësimit të mbrojtjes së konsumatorit, u forcuan kërkesat për transparencë në produktet dhe shërbimet financiare, veçanërisht në drejtim të informimit të klientëve për normat e interesit, kostot totale, komisionet dhe kushtet kontraktuale. Gjithashtu, me qëllim menaxhimit më efektiv të rrezikut kibernetik në sistemin bankar dhe forcimin e vigjilencës mbikëqyrëse, u hartuan “Udhërrëfyesi i Vetëvlerësimit të Rrezikut Kibernetik”, në përputhje me standardin ISO/IEC 27002, dhe projekt-rregullorja “Për qëndrueshmërinë operationale digjitale”, në përputhje me kërkesat e BE-së.

Sistemi financiar është monitoruar përmes inspektimeve në vend, vlerësimit të ekspozimit ndaj rreziqeve dhe mbikëqyrjes së administrimit të tyre. Gjatë vitit 2025 u kryen 12 ekzaminime në banka, me fokus kryesor rrezikun e kredisë dhe cilësinë e aktiveve, rrezikun e likuiditetit, marrëdhëniet me palët e lidhura, etj.. Rekomandimet e lëna kanë synuar një qasje prudeniale në drejtim të zhvillimit të veprimtarisë së shëndetshme bankare. Inspektimet në institucionet jobanka kanë pasur një fokus të gjerë, duke mbuluar, krahas rreziqeve tipike të aktivitetit, edhe sistemet e qeverisjes, transparencën me klientët dhe rrezikun e pastrimit të parave. Këto rekomandime kanë adresuar përmirësimin e cilësisë së qeverisjes, plotësimin e kuadrit të brendshëm organizativ dhe rregullator, si dhe mbështetjen me sisteme të automatizuara dhe teknologji.

Në fushën e licensimit, zhvillim kryesor ishin miratimet paraprake për licencimin e degës së bankës së huaj (Ziraat Bank) dhe licencimin e bankës digjitale (JET Bank), si dhe bashkimi me përthithje i Bankës Amerikane të Investimeve me subjektin financiar jobankë NOA sh.a..

iv. Në fushën e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, vijoi puna për forcimin e kapaciteteve të bankave për zbatimin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, duke monitoruar programet vjetore të zhvillimit të kapaciteteve, operacionalizuar instrumentet e ndërhyrjes dhe përgatitur dokumente udhëzuese për rritjen e zbatueshmërisë. Progres i rëndësishëm u arrit në drejtim të përmbushjes së nivelit të ndërmjetëm të kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrimeve të pranuara (MREL) nga të gjitha bankat. Fondi i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme arriti në 7.02 miliardë lekë. BSH punoi për plotësimin e kuadrit ligjor dhe metodologjik dhe nisi rishikimin e kuadrit ligjor të ndërhyrjes së jashtëzakonshme për ta përafruar me standardet e BE-së.

v. Në fushën e infrastrukturës së pagesave, përfundoi projekti për përditësimin e sistemeve kombëtare të pagesave me standardin ndërkombëtar ISO 20022, si dhe ndryshoi kuadri rregullator i funksionimit të tyre, me përfitime të ndjeshme në terma të uljes së kostove për klientët. Gjithashtu, anëtarësimi i Shqipërisë në Tregun Unik të Pagesave në Euro (SEPA) uli ndjeshëm kostot dhe rriti shpejtësinë dhe sigurinë e transfertave me vendet anëtare. Si rrjedhojë e punës së vazhdueshme në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës së pagesave, uljes së kostove të përdorimit të tyre dhe investimit në edukimin financiar, viti 2025 shënoi rezultate të rëndësishme në drejtim të rritjes së përdorimit të pagesave elektronike dhe atyre digjitale.

vi. Banka e Shqipërisë garantoj qarkullimin cilësor dhe të sigurt të Lekut.

vii. Administrimi i rezervës valutore u realizua në përputhje me respektimin e parimeve themelore të sigurisë dhe likuiditetit. Në fund të vitit, stoku i rezervës valutore bruto u rrit në 7,305.46 milionë Euro, nga 6,268.01 milionë Euro një vit më parë, duke rritur më tej aftësinë paguese të vendit. Kthimi nga administrimi i rezervës ka rezultuar pozitiv, duke pasqyruar si performancën e treguesve referencë dhe administrimin aktiv.

viii. Në fushën e prodhimit dhe transmetimit të statistikave, vijoi puna për forcimin e menaxhimit dhe qeverisjes së të dhënave, rritjen e granularitetit dhe cilësisë së statistikave, si dhe harmonizimin me standardet e BE-së. Në kuadër të integritetit evropian, një arritje e rëndësishme ishte raportimi për herë të parë në Eurostat i të dhënave të Procedurës së Deficitit të Tejkalar, duke përmblusur një nga piketat kryesore të Kapitullit 18. Gjithashtu, vijoi puna për përafrimin me *acquis* të BE-së në fushën e mbikëqyrjes bankare, modernizimin e infrastrukturës statistikore dhe forcimin e koordinimit institucional.

ix. Në fushën e kërkimit shkencor, veprimtaria u fokusua në analizën e zhvillimeve ekonomike dhe financiare me rëndësi për politikën monetare dhe stabilitetin financiar, duke adresuar njëkohësisht çështje strukturore si emigracioni dhe ndryshimet demografike, financa e gjelbër dhe rreziqet klimatike për sistemin bankar, si edhe në thellimin e edukimit dhe përfshirjes financiare.

x. Në fushën e edukimit financiar, nismat e ndërmarra në kuadër të zbatimit të Strategjisë së Bankës së Shqipërisë për Edukimin dhe Përfshirjen Financiare synuan forcimin e mëtejshëm të njohurive dhe kulturës së qëndrueshme financiare, duke e lidhur edukimin në këtë fushë me trashëgiminë historike dhe identitetin monetar kombëtar në funksion të rritjes së mirëqenies afatgjatë. Aktivitetet e vitit 2025 u orientuan nga kremtimi i 100-vjetorit të Bankës së Shqipërisë dhe përgatitjet për 100-vjetorin e monedhës kombëtare shqiptare.

xi. Nëpërmjet Departamentit të Kontrollit, është **forcuar efektshmëria e kontrolleve për funksionet, proceset dhe aplikacionet mbështetëse** në Bankë. Gjithashtu, ka vijuar aktiviteti në drejtim të forcimit të administrimit të rrezikut operacional dhe të përmirësimit të aftësisë reaguese të Bankës në kuadër të vijueshmërisë së veprimtarisë.

5. VEPRIMTARIA E KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Këshilli Mbikëqyrës zhvilloi 16 mbledhje gjatë vitit 2025. Tetë prej tyre iu dedikuan politikës monetare, katër stabilitetit financiar dhe mbikëqyrjes, ndërsa mbledhjet e tjera trajtuan: (i) programin vjetor të Këshillit; (ii) raportin vjetor dhe rezultatin financiar; (iii) pasqyrat financiare dhe (iv) strategjinë afatmesme, buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm.

Në rolin e tij si organi më i lartë vendimmarrës i BSH-së, Këshilli miratoi 73 vendime në përmblusje të funksioneve dhe përgjegjësi ligjore të tij. Këto vendime lidhen kryesisht me: (i) ruajtjen e stabilitetit të çmimeve; (ii) licensimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e bankave dhe institucioneve të tjera financiare; si dhe (iii) sigurimin dhe zhvillimin e infrastrukturës financiare, përfshirë emetimin e kartëmonedhave dhe monedhave, funksionim e sistemeve të pagesave, zhvillimin e tregut ndërbankar dhe prodhimin e statistikave financiare. Krahas tyre, Këshilli miratoi dhe një sërë vendimesh strategjike të orientuara drejt rritjes së efikasitetit institucional, modernizimit të strukturës organizative, forcimit të qeverisjes dhe përdorimit optimal të burimeve financiare. Në nëntor, ai miratoi Strategjinë Afatmesme të Zhvillimit të Bankës së Shqipërisë 2026-2028, duke ruajtur të pandryshuar misionin, vizionin dhe vlerat e Bankës.

Në rolin e tij si organ më i lartë mbikëqyrës i BSH-së, Këshilli u informua rregullisht nga strukturat e kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm mbi respektimin e kuadrit ligjor dhe rregullator që orienton veprimtarinë e përditshme të BSH-së. Në përputhje me kompetencat e përcaktuara në ligjin organik, Këshilli miratoi gjithashtu raportet dhe rekomandimet që Banka e Shqipërisë i paraqet Kuvendit dhe Këshillit të Ministrave, si dhe raportin vjetor dhe atë financiar të institucionit. Publikimi i këtyre raporteve forcon transparencën, llogaridhënien dhe besueshmërinë e institucionit ndaj publikut.

6. INTEGRIMI EVROPIAN DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Banka e Shqipërisë vijoi të mbështesë aktivisht procesin e integritetit evropian, duke marrë pjesë në grupet ndër-institucionale dhe duke kontribuar në hartimin e dokumenteve strategjike për përafrimin e legjislacionit dhe politikave me *acquis* të Bashkimit Evropian.

Banka udhëhoqi punën për kapitullin 4 “Lëvizja e lirë e kapitalit” dhe kapitullin 17 “Politika ekonomike dhe monetare”, duke përgatitur dhe ndjekur planet e punës, si dhe duke bashkëpunuar ngushtë me institucionet kontribuuese dhe Zyrën e Kryenegociatorit. Krahas këtyre dy kapitujve, BSH kontribuoi edhe për Kapitujt 9 – Shërbimet Financiare, 18 – Statistikat dhe 28 – Mbrojtja e Konsumatorit, ndërsa vijoi përpjekjet për përafrimin e plotë të legjislacionit të saj, përfshirë ligjet për Bankën e Shqipërisë, bankat dhe shërbimet e pagesave.

Në raportin e Progresit 2025 të Komisioni Evropian, Shqipëria vlerësohet në nivel “të moderuar dhe të mirë” përgatitjeje në Kapitujt 4 dhe 17, duke veçuar anëtarësimin në SEPA dhe stabilitetin e çmimeve si elementë pozitivë të përparimit të vendit.

Banka ruajti gjithashtu një bashkëpunim të ngushtë me institucionet e huaja për shkëmbimin e analizave dhe përforsimin e bashkërendimit të politikave makroekonomike dhe ekspertizës profesionale. Roli dhe kontributi i saj në ruajtjen e stabilitetit monetar e financiar u vlerësua pozitivisht edhe nga partnerët ndërkombëtarë, përfshirë Fondin Monetar Ndërkombëtar, Komisionin Evropian dhe Bankën Qendrore Evropiane.

7. PRIORITETET AFATMESME

Strategjia Afatmesme e Zhvillimit 2026-2028 përcakton objektivat institucionale të Bankës së Shqipërisë dhe shërben si udhëzues për përgatitjen e buxhetit orientues afatmesëm. Objektivat përfshijnë edhe rekomandimet e Rezolutës së Kuvendit për vlerësimin e veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë.

Prioritetet kryesore janë:

- a) Rritja e efektivitetit të politikës monetare dhe e cilësisë së vendimmarrjes, përmes zgjerimit të instrumenteve të politikës monetare, përditësimit të modeleve makroekonometrike, rritjes së bashkëpunimit me autoritetet vendase, përmbyshjes së kërkesave për përafrimin me BE-në, dhe përmirësimit të komunikimit me publikun për të rritur kuptueshmërinë dhe njohuritë mbi vendimmarrjen.
- b) Parandalimi i rreziqeve sistematike dhe rritja e rezistencës së sistemit financiar, përmes pasurimit me instrumente makroprudenciale të targetuar për rreziqet sistematike strukturore; përmirësimit të metodologjive të ushtrimit të provës së rezistencës; sigurimit të ekuivalencës dhe përshtatjen e mëtejshme të kuadrit ligjor dhe nënligjor për mbikëqyrjen me legjislacionin evropian; pjesëmarrjes në kolegjet mbikëqyrëse të grupeve të rëndësishme bankare evropiane; mbikëqyrjes së rreziqeve kibernetike dhe inovacionit financiar, dhe përditësimi të planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.
- c) Sigurimi i funksionimit normal të sistemit të pagesave përmes implementimit të një sistemi *Instant Payments* në bashkëpunim me Bankën e Italisë dhe mbështetjes së ofruesve të shërbimeve financiare në pjesëmarrjen në skemat e Tregut Unik të Pagesave në euro.
- d) Ruajtja e besimit të kartëmonedha dhe monedha shqiptare, përmes plotësimit të nevojave të ekonomisë për para të gatshme dhe mbrojtjes nga falsifikimi.
- e) Rritja e kapaciteteve investuese dhe diversifikimi i portofolit të rezervës valutore në përputhje me rritjen e nivelit të rezervave valutore, përmes përfshirjes së klasave të reja të instrumenteve financiare.
- f) Hartimi dhe shpërndarja e statistikave, sipas praktikave më të mira dhe standardeve evropiane.
- g) Zgjerimi i edukimit dhe kulturës financiare, përmes pranisë në mediat sociale, ekspozitave dhe aktiviteteve publike.
- h) Përmirësimi i infrastrukturës dhe harmonizimi i mëtejshëm me standardet ndërkombëtare, përfshirë raportimin financiar, kuadrin kontabël, sigurinë IT dhe sistemin e kontrollit të brendshëm.
- i) Modernizimi i kuadrit rregullativ për mbikëqyrjen e rrezikut kibernetik, në përputhje me legjislacionin dhe praktikën evropiane.